



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"  
VLORE  
ZYRA - PROTOKOLL - ARKIVËS  
1039  
DATA 23.04.2024  
PROT.

Nr. 4/Prot

Datë, 27.04./2024

**VENDIM**  
Nr. 2, datë 27.04.2024

**PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORE**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në zbatim të nenit 7 pika 6/d, nenit 18 pika 3 të vendimit të Senatit Akademik nr. 11, datë 21.03.2024 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë".

Komisioni Zgjedhor i Fakultetit, në mbledhjen e datës 27.04.2024

**VENDOSI:**

1. Të miratojë hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore në Universitetin "Ismael Qemali", Vlorë.
  2. Të miratojë periudhën kohore të regjistrimit të kandidatëve datën 7.05.2024, deri në datën 13.05.2024, brenda orarit zyrtar 08:00-16:00.
  3. Procesi i regjistrimit kryhet kur kandidati paraqitet personalisht në zyrën e Komisionit Zgjedhor të Fakultetit për të depozituar dokumentacionin për kandidim.
  4. Pas regjistrimit, kandidati i jepet vërtetimi i regjistrimit si kandidat nga Komisioni Zgjedhor i Fakultetit.
  5. Vendimi publikohet në të gjitha mjediset e Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Natyrore në Universitetin "Ismael Qemali" dhe në sitin zyrtar [www.univlor.edu.al](http://www.univlor.edu.al).
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar i Komisionit Zgjedhor i Fakultetit**

**Dr. Alma Sheko**

**ANËTARËT:**

Eni Meli

Orjada Jorgji



Nr. 5 Prot

Datë, 27.04.2024

## NJOFTIM

### **PËR HAPJEN E PROCESIT TË REGJISTRIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË NJËSISË KRYESORE, DREJTUES TË NJËSISË BAZË, PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME NË NJËSINË KRYESORE NË FAKULTETIN E SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI" VLORË**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të senatit akademik Nr.11, datë 21.03.2024 "Për miratimin e Rregullores për organizmin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismael Qemali" Vlorë", bazuar në nenin 25; Vendimit të Komisionit Zgjedhor të Fakultetit Nr.2, datë 27.04.2024 "Për hapjen e procesit të regjistrimit të kandidatëve për Drejtues të Njesisë Kryesore, Drejtues të Njesisë Bazë, për Anëtarët e Komisioneve të Përhershme në Njesisë Kryesore në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore".

Kërkesa për kandidim nga personat e interesuar depozitohet nga kandidati në Fakultetin e Shkencave Teknike dhe Natyrore, kati i dytë, godina C, nga data 7.05.2024, deri në datën 13.05.2024, brenda orarit zyrtar 8:00-16:00.

#### **I - Kandidatët për Drejtues të Njesisë Kryesore dhe Drejtues të Njesisë Bazë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm.**

- a) Kërkesa për kandidim, e cila përmban emrin, atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
- i. Deklarimin se kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në RSH", si autoritet drejtues në postin për të cilin kërkon të kandidojë në të njëjtin institucion;
- ii. Deklarimin e mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
- iii. Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
- iv. Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
- v. Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
KOMISIONI ZGJEDHOR I FAKULTETIT TË SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE

**II - Kandidatët për Anëtar të Komisioneve të Përhershme duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm**

- a) Kërkesa për kandidim, e cila përmban emrin, atësinë; mbiemrin; datëlindjen; gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) Kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Formularët e vetëdeklarimit, të cilët kandidati i tërheq pranë KIZ-it;
  - i. Deklarimin e mungesës së plagjiaturës në punimet për fitimin e gradës shkencore dhe titullit akademik;
  - ii. Deklarimin se nuk ka shkak për të qenë objekt i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë";
  - iii. Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale.
  - iv. Deklarimin për neutralitetin politik, mosqenien pjesë e forumeve të larta politike në vend.

**Kryetar i Komisionit Zgjedhor i Fakultetit**

**Dr. Alma Sheko**

**ANËTARËT:**

**Eni Meli**

**Orjada Jorgji**